

Raporti Vjetor i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat financiare  
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023

**OJQ "NEVO KONCEPTI"**

**PRIZREN, KOSOVË**

Prill, 2024

PËRMBAJTJA:

|  |      |
|--|------|
| Raporti i auditorit të pavarur           | 3-4  |
| Pasqyra e pozitës financiare             | 5    |
| Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse | 6    |
| Pasqyra e ndërrimeve në ekuitet          | 7    |
| Pasqyra e Rrjedhës së parasë             | 8    |
| Shënimet e pasqyrave financiare          | 9-14 |

# RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për: Bordin drejtues të OJQ “ NEVO KONCEPTI ” – Prizren

## Raport mbi pasqyrat financiare

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të OJQ “ NEVO KONCEPTI ” të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar me datën 31 dhjetor 2023, Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Fonde dhe Pasqyrën e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të OJQ “ NEVO KONCEPTI ” bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të OJQ “ NEVO KONCEPTI ” me datën 31 dhjetor 2023, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përpilimit të raportimit financiar të përshkruara në paragrafin 2.1 të këtij raporti.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (*Kodi i BSNEPK*) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të OJQ “ NEVO KONCEPTI ” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar në raportin e tyre të datës 28 Mars 2023.

### *Përgjegjsia e menagjmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave Financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që menagjmenti I gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e Pasqyrave Financiare, menagjmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menagjmenti synon ta likuidojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

## Përgjegjësit e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse Pasqyrat Financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim I kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA –të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku I mos zbulimit të një anomalie material si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku që rrjedh si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri material në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në lidhje me shpjegimet e dhëna në Pasqyra Financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit.

Megjithatë, ngjarjet ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithëshme, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

HLB Audit Kosova L.L.C.

Saibe Karabaxhaku Bytyqi, Auditor Ligjor



24 prill 2024

# DJQ "NEVO KONCEPTI" - PRIZREN

Pasqyra e pozitës financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

| <b>PASURITË</b>  | <b>Shënimi</b> | <b>2023</b>   | <b>2022</b>  |
|--|----------------|---------------|--------------|
|  |                | <b>Euro</b>   | <b>Euro</b>  |
| Pasuritë afatshkurtra                                  |                |               |              |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë                       | 4              | 47,740        | 5,489        |
| Parapagimet tjera                                      | 5              |               | 75           |
| <b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>                  |                | <b>47,740</b> | <b>5,564</b> |
| <b>Pasuritë afatgjata</b>                              |                |               |              |
| <b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>                     |                | -             | -            |
| <b>GJITHSEJ PASURITË</b>                               |                | <b>47,740</b> | <b>5,564</b> |
| <b>FONDET DHE DETYRIMET</b>                            |                |               |              |
| <b>Detyrimet afatshkurtra</b>                          |                |               |              |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera            | 6              | 1,517         | 1,370        |
| <b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>                 |                | <b>1,517</b>  | <b>1,370</b> |
| <b>Detyrimet afatgjata</b>                             |                |               |              |
| <b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>                    |                | -             | -            |
| <b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>                              |                | <b>1,517</b>  | <b>1,370</b> |
| <b>FONDET</b>  |                |               |              |
| Neto rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara |                | 4,194         | 5,107        |
| Neto rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese    |                | 43,546        | (913)        |
| Kthim i fondeve  |                | (1,517)       |              |
| <b>Gjithsej fondet</b>                                 | <b>7</b>       | <b>46,223</b> | <b>4,194</b> |
| <b>GJITHSEJ FONDET DHE DETYRIMET</b>                   |                | <b>47,740</b> | <b>5,564</b> |

Pasqyrat financiare janë nënshkruar dhe aprovuar nga menaxhmenti i kompanisë me datën 10 mars 2024 dhe janë nënshkruar në emër të:

Drejtori i përgjithshëm/ Ekzekutiv  
Osman Osmani

Drejtori financiar/Kontabilisti i Qertifikuar



*[Handwritten signature]* 02-112/2022

## DJQ "NEVO KONCEPTI"-PRIZREN

### Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023

| Të ardhurat   | Shënimi   | 2023           | 2022           |
|---|-----------|----------------|----------------|
|   |           | Euro           | Euro           |
| Të hyrat nga Grantet dhe Donacionet                     |           | 177,159        | 215,116        |
| Te hyrat tjera  |           | 3,163          | 3              |
| <b>Gjithsej te ardhurat bruto</b>                       | <b>8</b>  | <b>180,322</b> | <b>215,119</b> |
| <b>Shpenzimet</b>                                       |           |                |                |
| <b>Shpenzimet programore</b>                            |           |                |                |
| Pagat dhe mëditjet bruto                                |           | 18,549         | 53,380         |
| Shpenzimet programore                                   |           | 34,144         | 71,011         |
| <b>Gjithsej shpenzimet programore</b>                   | <b>9</b>  | <b>52,693</b>  | <b>124,391</b> |
| <b>Menaxhment dhe administratë</b>                      |           |                |                |
| Pagat dhe mëditjet bruto                                |           | 69,268         | 87,549         |
| Shpenzimet operative                                    |           | 9,749          | 3,953          |
| <b>Gjithsej shpenzimet e menaxhmentit</b>               | <b>10</b> | <b>84,083</b>  | <b>91,502</b>  |
| Shpenzimet tjera  | 11        | 5,066          | 139            |
| <b>Gjithsej shpenzimet tjera</b>                        |           | -              | 139            |
| <b>Gjithsej shpenzimet</b>                              |           | <b>136,776</b> | <b>216,032</b> |
| Net rritje / pakësim nga operacionet                    |           | 43,546         | (913)          |
| Shpenzimet e tatimit në fitim                           |           | -              | -              |
| <b>Neto rritje / pakësim i fondeve të periudhës</b>     |           | <b>43,546</b>  | <b>(913)</b>   |
| Neto rritje / pakësim i fondeve nga periudhat e kaluara |           | 4,194          | 5,107          |
| Kthim i Fondeve   |           |                |                |
| <b>Fondet e mbajtura në fund të vitit</b>               | <b>7</b>  | <b>47,740</b>  | <b>4,194</b>   |

## **OJQ "NEVO KONCEPTI"-PRIZREN**

**Pasqyra e ndryshimeve në fonde për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

|                                       | <b>Fondet<br/>Fillestare</b> | <b>Fondet e<br/>Akumuluar</b> | <b>Rezervat<br/>tjera</b> | <b>Gjithsej</b> |
|---------------------------------------|------------------------------|-------------------------------|---------------------------|-----------------|
|                                       | <b>€</b>                     | <b>€</b>                      | <b>€</b>                  | <b>€</b>        |
| <b>Me 1 janar 2022</b>                |                              | <b>5,107</b>                  | -                         | <b>5,107</b>    |
| Neto rritje / pakësim nga operacionet |                              | (913)                         |                           | (913)           |
| <b>Me 31 dhjetor 2022</b>             |                              | <b>4,194</b>                  |                           | <b>4,194</b>    |
| Neto rritje / pakësim nga operacionet |                              | 43,546                        |                           | 43,546          |
| <b>Me 31 dhjetor 2023</b>             |                              | <b>47,740</b>                 |                           | <b>47,740</b>   |

## QJQ "NEVO KONCEPTI"-PRIZREN

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

|   | Shënimi  | Me 31 dhjetor<br>2023<br>€ | Me 31 dhjetor<br>2022<br>€ |
|---|----------|----------------------------|----------------------------|
| <b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>                                    |          | 43,564                     | (913)                      |
| <i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave:</i> |          |                            |                            |
| Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve                        | 7        |                            |                            |
| <b><i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i></b>          |          |                            |                            |
| (Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera                              |          | 75                         | (75)                       |
| Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera      | 8        | 147                        | 1,370                      |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>                |          | <b>222</b>                 | <b>382</b>                 |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>                    |          |                            |                            |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>               |          | -                          | -                          |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>               |          |                            |                            |
| Fondet e kthyer   |          | (1,517)                    |                            |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>               |          | <b>(1,517)</b>             |                            |
| <b>Rritja / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b> |          | <b>42,251</b>              | <b>382</b>                 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit                   | 4        | 5,489                      | 5,107                      |
| <b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>              | <b>4</b> | <b>47,740</b>              | <b>5,489</b>               |



## 1. Informata të përgjithshme

**Nevo Koncepti** është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014, sipas Ligjit Nr. 06/ L-043, Neni 15 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, si vazhdimësi e aktiviteteve të shumta që nga paslufta të aktivistëve romë. Themeluesit e organizatës janë intelektualët romë, të cilët për shumë vite kanë qenë të angazhuar në mënyra të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe përparimin e situatës së romëve në pjesë të ndryshme të Kosovës, fillimisht duke përfshirë Prizrenin, Gjakovën, Ferizajin, Pejën, Rahovecin, Fushë Kosovën, dhe Suharekën, duke vazhduar më pas edhe në gjithë territorin e vendit bashkë me partnerë të organizatave joshumicë.

Adresa e OJQ -së është: Rr. "Adnan Krasniqi" 149 hyrja II/8, Prizren

**Kryesues i bordit të OJQ-së: Daut Qylangji**

**Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së: Osman Osmani**

### Misioni i "NEVO KONCEPTI"

Mbrojtja e të drejtave të njeriut me theks i komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptas përmes promovimit dhe ndikimit në zhvillimin e politikave publike në favor të grupeve të cenushme të shoqërisë.

### Projektet e OJQ "NEVO KONCEPTI"

**"Fuqizimi i komuniteteve të cenushme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës"**

**Kohëzgjatja e Projektit: 01.10.2023 deri më 30.09.2026.**

- Qëllimi i projektit është fuqizimi vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian duke mbështetur në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe mundësi të nevojshme për një tranzicion të suksesshëm për moshat madhore dhe punë dinjetoze të qëndrueshëm.
- Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim me pjesëmarrje financiare nga Save the Childer dhe implementohet nga OJQ "Nevo Koncepti".

**"Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe Shqipëri"** është projekt i implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Nevo Kocepti (NVK)/Kosovë dhe Drejtësi Sociale (DS)/Shqipëri, në partneritet me Karl Kubel Stiftung (KKS), dhe me përkrahje financiare të Ministrisë Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).

**Kohëzgjatja e projektit: 01.11.2023 – 30.04.2027**

*Projekti ka katër qëllime:*

*\*Përmisimin e përfshirjes në shkollë dhe edukimin e fëmijëve romë.*

*\*Përmisimin e integritit të romëve në tregun e punës.*

*\*Përmisimin e qasjes në kujdesin shëndetësor për romët*

*\*Përmisimin e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave për romët.*

**Parandalimi i Braktisjes, Përmirësimi i Vijueshmërisë së Shkollimit dhe Ngritja e Suksesit të Nxënësve me Probleme në Mësimnxënje nga Rradhët e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian Përmes Mbështetjes me Orë Plotësuese dhe Aktivitete Përcjellese Arsimore", financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.**

**Kohëzgjatja e projektit: 01.09.2023 deri më 30.06.2024**

Qëllimi i projektit është të ndikoj direkt te nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian duke përmirësuar vijueshmërinë, parandalimin e braktisjes, ngritjen e suksesit të nxënësve me probleme në mësimnxënje, socializimin e fëmijëve dhe ngritjen e ndergjegjësisimit të prindërve ndaj shkollimit të fëmijëve. Target grupi i projektit janë nxënësit nga klasa I – IX. Mesimi plotësues zhvillohet në tre qendrat mësimore me bazë në shkollë: Lekë Dukagjini, Mati Logoreci në Prizren dhe Dy Dëshmoret në Pirane.

**"Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve"**

Kohëzgjatja e projektit: 01.06.2022 – 31.12.2026

Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" është projekt i implementuar nga Nevo Kocepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

## **Partnerët:**

**Save the Children Kosova, Karl Kübel Stiftung, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.**

## **2. POLITIKAT KONTABËL**

### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të zbatueshme në republikën e Kosovës dhe në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L-043 që aktualisht janë në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe mbi bazën e kontabilitetit të përcaktuar në marrëveshjen me donatorët duke përfshi edhe buxhetimin.

#### **(a) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### **(b) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në €, e cila është monedha funksionale e Republikës së Kosovës.

#### **(c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumëve të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

## **3. Përmbledhje e politikave kontabël**

### **(a) Ndryshime në politikat kontabël**

Nuk ka ndryshime në politikat kontabël në vitet e paraqitura.

### **(b) Transaksionet në monedha të huaja**

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, dhe depozita bankare afatshkurtra. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parave, arka dhe banka përfshijnë edhe depozitat e mbajtura si garanci nga banka me maturitet me pak se tre muaj nga data origjinale.

#### *Furnitorë dhe të tjera të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

#### 4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

|                           | 31.12.2023    | 31.12.2022   |
|---------------------------|---------------|--------------|
| Paraja në arkë            |               | -            |
| ADA 150-020500016373-85   | 45            |              |
| 150-020500019825-11 SIDA  | 36            |              |
| 150-020500015887-88       | 5,171         |              |
| 150-020500018356-53 MASHT | 3,001         |              |
| 150-020010056048-96 KKS   | 35,293        |              |
| <b>Total Paraja</b>       | <b>47,740</b> | <b>5,489</b> |

#### 5. Parapagimet tjera

|              | 31.12.2023 | 31.12.2022 |
|--------------|------------|------------|
| Parapagime   | -          | 75         |
| <b>TOTAL</b> | <b>-</b>   | <b>75</b>  |

Kompania nuk ka njohur ndonjë humbje nga dëmtimi kundrejt të arkëtueshmeve tregtare.

#### 6. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

|                       | 31.12.2023   | 31.12.2022   |
|-----------------------|--------------|--------------|
| Llogaritë e pagueshme | 1,517        | 1,370        |
| <b>TOTAL</b>          | <b>1,517</b> | <b>1,370</b> |

#### 7. Fondet

| Fondet  | 31.12.2023    | 31.12.2022   |
|---|---------------|--------------|
| Neto rritje / pakësim i fondeve nga periudhat e kaluara | 4,194         | 5,107        |
| Neto rritje / pakësim i fondeve nga periudha vijuese    | 43,546        | (913)        |
| Kthim Donatorëve  |               | -            |
| <b>Totali</b>   | <b>47,740</b> | <b>4,194</b> |

**8. Të hyrat**

|                        | Për vitin e<br>përfunduar me<br>31.12.2023 | Për vitin e përfunduar<br>me<br>31.12.2022 |
|------------------------|--|--|
| Të Hyrat nga Projektet |  |  |
| REACH II               | 40,158                                     | -  |
| Prospect 3             | 5,962                                      | -  |
| SIDA                   | 54,085                                     | -  |
| ADA                    | 5,860                                      | -  |
| KKS/P7414              | 6,682                                      | -  |
| VoRAE                  | 10,464                                     | -  |
| MASHTI                 | 53,949                                     | -  |
| Të hyrat tjera         | 3,163                                      | -  |
| <b>Gjithsej</b>        | <b>180,322</b>                             | <b>215,119</b>                             |

**9. Shpenzimet Programore**

|                          | Për vitin e përfunduar<br>me 31.12.2023 | Për vitin e përfunduar<br>me 31.12.2022 |
|--------------------------|---|---|
| Pagat dhe mëditjet bruto | 18,549                                  | 53,380                                  |
| Shpenzimet programore    | 34,144                                  | 71,011                                  |
| <b>Gjithsej</b>          | <b>52,693</b>                           | <b>124,391</b>                          |

**10. Shpenzimet Menaxhment dhe administratë**

|                          | Për vitin e përfunduar<br>me 31.12.2023 | Për vitin e përfunduar<br>me 31.12.2022 |
|--------------------------|---|---|
| Pagat dhe mëditjet bruto | 69,268                                  | 87,549                                  |
| Shpenzimet operative     | 9,749                                   | 3,953                                   |
| <b>Gjithsej</b>          | <b>79,017</b>                           | <b>91,502</b>                           |

**11. Shpenzimet tjera**

|                  | Për vitin e përfunduar<br>me 31.12.2023 | Për vitin e përfunduar<br>me 31.12.2022 |
|------------------|---|---|
| Shpenzimet tjera | 5,066                                   | -                                       |
| <b>Gjithsej</b>  | <b>5,066</b>                            | <b>-</b>                                |

**12. Aprovimi i pasqyrave financiare**

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më 20.03.2024.